



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

BULETINI STATISTIKOR

JANAR - DHJETOR, 2024

Tabela e Lëndës

1	Treguesit kryesorë të veprimtarisë audituese
2	Mesazhet në Auditimet e Performancës
3	Konkluzionet në Auditimet IT
4	Niveli i Zbatueshmërisë së Rekomandimeve
5	Zhvillimi dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
6	Programi i Transparencës dhe e Drejta për Informim
7	Auditime në media
8	Aneksë

AKRONIME

ISSAI - Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

EUROSAI - Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit

GAO - Zyra e Përgjegjshmërisë Qeveritare, SHBA

ECA - Gjykata Evropiane e Audituesve

CEF - Qendra e Ekselencës në Ekonomi e Lubjanës

SAI - Institucione Supreme të Auditimit

TIK - Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

TI - Teknologjia e Informacionit

AKTIVITETI I KLSH PËRMES SHIFRAVE




*43 auditime përputhshmërie, 45 auditime financiare dhe 35 auditime të kombinuara

1. TREGUESIT KRYESORË TË VEPRIMTARISË AUDITUESE

1.1 Auditimet sipas llojit

Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën janar-dhjetor 2025, ka vijuar punën audituese në zbatim të planit të miratuar me Vendimin nr. 210, datë 18.12.2023, të Kryetarit të KLSH, duke kryer dhe evaduar **159** misione auditimi, nga 155 auditime të planifikuara, në vlerësim të përputhshmërisë, rregullshmërisë financiare, performancës, IT dhe ndjekjes së statusit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në periudha të mëparshme. Detajuar sipas llojit të auditimit, aktiviteti auditues paraqitet në tabelën në vijim:

Infografik nr. 1: Misionet e auditimit të evaduara, në numër dhe përqindje ndaj totalit



*përfshirë edhe 17 institucionet e administrimit të aseteve

1.2 Institucionet ku janë kryer auditimet

Në periudhën janar - dhjetor 2024, auditimet e kryera kanë përfshirë vlerësimin e aktivitetit në 205 subjekte, duke përfshirë nivele të ndryshme të qeverisjes si: institucione qendrore, ministri dhe agjenci (përfshirë drejtori qendrore dhe rajonale në varësi të tyre), njësi të vetëqeverisjes vendore, drejtori të përgjithshme të administrimit fiskal, shoqëri aksionere me kapital shtetëror në të cilat shteti zotëron mbi 50% të aksioneve, etj

Infografik nr. 2: Kategoritë e institucioneve të audituara, në numër



1.3 Opinionet/mesazhet/konkluzionet sipas llojit të auditimit

Bazuar në planin vjetor 2024, Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën janar – dhjetor 2024, ka përfunduar kryerjen e 159 misioneve të auditimit, duke konkluduar në:

- 80 opinione/konkluzione për auditime financiare
- 78 opinione/konkluzione për auditime të përputhshmërisë;
- 15 mesazhe auditimi për 15 auditimet e performancës;
- 21 konkluzione në 8 auditime IT, dhe 13 auditime për zbatimin e rekomandimeve

Infografik nr. 3: Opinionet/mesazhet/konkluzionet



Opinionet, mesazhet dhe konkluzionet e auditimit, të ndara sipas llojit të auditimit, paraqiten në tabelën më poshtë:

Tabela nr.1: Opinionet/mesazhet/konkluzionet sipas llojit të auditimit

Lloji i auditimit	Lloji i opinionit		Të tjera		Total
	I modifikuar	I pamodifikuar	Konkluzione	Mesazhe	
Financiar	29	16	-	-	45
Të kombinuar nga të cilët:					
<i>Financiar</i>	20	9	6	-	35
<i>Përputhshmërie</i>	33	2	-	-	35
IT	-	-	8	-	8
Përputhshmërie	29	2	12	-	43
Performance	-	-	-	15	7
Auditim i Zbatimit të Rekomandimeve	-	-	13	-	8
Total	111	29	39	15	194

Mbështetur në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISSAI 100), në bazë të gjetjeve të konkluduara mbi evidencat e auditimit, materialitetit dhe përhapjes, opinionet e dhënë mund të jenë “i modifikuar” ose “i pamodifikuar”. Në vijim:


Opinionet e pamodifikuar mund të jenë:

- të pakualifikuar, ose
- të pakualifikuar me theksim çështje


Opinionet e modifikuar mund të jenë:

- të kualifikuar,
- të kundërt, ose
- refuzues

Infografik nr. 4: Ndarja e opinionëve, mesazheve dhe konkluzioneve sipas llojit



1.4 Rekomandimet sipas natyrës



1.4.1 Përmirësime ligjore & Masa organizative

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, për 159 auditimet e përfunduara, KLSH ka adresuar rekomandime për 2594 masa organizative dhe 28 propozime për ndryshime apo përmirësime ligjore, në institucionet publike të audituara, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e situatës, të paraqitura më hollësisht në tabelën në vijim:

Tabela nr.2: Përmirësime ligjore dhe masa organizative

Lloji i auditimit	Nr auditimesh	Masa organizative	Përmirësim ligjor	Gjithsej
Financiar	45	617		617
I kombinuar	35	850	8	858
IT	8	137	4	141
Performance	15	227	8	235
Përputhshmërie	43	763	8	771
Zbatimi i rekomandimeve	13			
Gjithsej	159	2594	28	2622

Rekomandimet për përmirësime ligjore janë dhënë:

- ✓ Në fushën e prokurimit publik sa i takon nevojës për harmonizimin e kuadrit ligjor lidhur me:
- a) afatet e ankimit administrativ në prokurimet publike të fushës së mbrojtjes dhe sigurisë;
 - b) rregullimin e procedurave dhe dokumentacionit të ankandëve publike;
 - c) sigurinë rrugore, sa i takon plotësimin të formularit të miratuar për kundravajtjen me elementë që synojnë të minimizojnë numrin e ankesave, si dhe kohën e trajtimit dhe kthimit të përgjigjes;
 - d) prokurimet publike në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, me qëllim propozimin e miratimit të ndryshimeve të nevojshme ligjore, që shmangin mungesën e koherencës ligjore dhe korrigjimin e mospërputhjes ligjore lidhur me afatet e ankesave për dokumentet e procedurave prokurorese; si dhe korrigjimin dhe ndryshimin e vlerës në kufijtë monetarë sipas përcaktimeve të Direktivës 2009/81/EC.

- ✓ Në fushën e shëndetësisë, me qëllim:

 - a) përditësimin e akteve nënligjore/rregulloret, për strukturat që administrojnë & riparojnë pajisjet mjekësore, si dhe trajnojnë personelin mjekësor, referuar nevojave që ato kanë në burime njerëzore dhe në kualifikimet që kërkohen,
 - b) nënshkrimin e një marrëveshjeje për inicimin e përditësimit të akteve ligjore dhe nënligjore, për të mundësuar nxitjen dhe orientimin e kurrikulave arsimore drejt zhvillimit të degës universitare të inxhinierisë bio-mjekësore,
 - c) rishikimin e ligjit “Për pajisjet mjekësore”, në përputhje me legjislacionin e BE – së, duke përfshirë të gjitha institucionet përgjegjëse me kompetencat e detyrat përkatëse,
 - d) hartimin e një dispozite rregullatore për funksionimin e Komisionit Teknik të Listës së Barnave të Rimbursueshme, kushtëzuar dhe me ndryshimet në mjedisin aktual që vepron institucioni, duke përfshirë faza, afate dhe struktura të harmonizuara që të përgatitin LBR të përvitshme dhe që merr në konsideratë faktorët mbi të cilët ajo hartohet,
 - e) miratimin e një akti nënligjor VKM, për krijimin e bazës së të dhënave për Sistemin e Informacionit të Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore,
 - f) ndryshimet përkatëse në VKM nr. 761, datë 12.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.553, datë 15.7.2020 “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”, duke riklasifikuar si Infrastrukturë Kritike të Informacionit “Sistemin e Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (SIRKB)”, duke marrë parasysh rëndësinë që ky sistem ka në shëndetin e qytetarëve.

- ✓ Shtimin e fotos si përbërës zgjedhor në nenin 45 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, për sa kohë ky element vlerësohet i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për identifikimin e votuesve.

- ✓ Përditësimin e ligjit për birësimet dhe të gjitha akteve të tjera ligjore e nënligjore në fushën e birësimeve, bazuar edhe në praktika të tjera të mira ndërkombëtare, veçanërisht në drejtim të përcaktimit të kufirit maksimal të moshës së birësuesit/birësuesve; qëndrueshmërisë e sigurisë së lidhjes martesore në kohë për aplikantët birësues të martuar; kriterit ekonomik për aplikantët birësues, etj.

- ✓ Marrjen e iniciativave ligjore të nevojshme për rishikimin dhe përmirësimin e VKM nr. 798 datë 29.9.2010 “ Për miratimin e rregullores, për administrimin e mbetjeve spitalore”, për të harmonizuar rregullat për administrimin e mbetjeve spitalore me Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

- ✓ Për marrëveshjet hidrokarbure, ku rekomandohet nevoja që të listohen qartë kriteret bazë të nevojshme në zbatim të Ligjit nr. 7746 datë 28.07.1993 “Për Hidrokarburet”, si dhe hartimin një (kontratë) tip për Marrëveshjet Hidrokarbure me qëllim lehtësimin e punës, si dhe hartimin dhe miratimin e manualeve për çmimet referencë dysHEME dhe tavan, për të mënjeluar fryrjen e buxheteve dhe situacioneve të kostove të rimbursuesh.

- ✓ Në fushën e sigurimeve shoqërore, ku rekomandohet nevoja për përmirësimin e nenit 62, pika 2 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar, i cili minimalisht të përmbajë një klasifikim të masës së penaltetit në varësi të shkeljes, duke parashikuar ose kufij maksimalë dhe minimalë të vlerës së gjobës, ose aplikimin e penaltetit të kategorizuar me fasha.
- ✓ Në fushën doganore, rekomandohet nevoja për miratimin e praktikave për verifikimin e vërtetësisë së pagesës detyrimeve doganore për mallrat me destinacion përfundimtar “Mbetje ne Njësi Spitalore” apo “Shitje ne Farmaci Publike ose Depo Farmaceutike” dhe reflektimin e tyre në kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.
- ✓ Në drejtim të përputhshmërisë me direktivat e Bashkimit Evropian, specifikisht direktivën e IORP II e cila mbulon, Institucionet e Planeve Profesionale të Pensionit, me qëllim përfshirjen në fushën e veprimtarisë mbikëqyrëse të tregut të pensioneve vullnetare edhe fondin e pensionit vullnetar të Bankës së Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, të marrë masat për kryerjen e propozimeve për ndryshime ligjore përkatëse.
- ✓ Në fushën e sigurisë, kemi propozuar nevojën e ndryshimeve të VKM-së nr.320, datë 02.6.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.881, datë 28.10.2020, për dhënien e statusit të veçantë akademisë së sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike në kuadër të harmonizimit të tij me përcaktimet e Ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”; si dhe nevojën për ndryshimet e nevojshme në Statutin e Akademisë, me qëllim reflektimin dhe zbatimin e ndryshimeve të parashikuara në VKM-në nr.320, datë 02.6.2021.
- ✓ Në drejtim të menaxhimit të zonave publike, ndër të tjera kemi rekomanduar nevojën për hartimin e Ligjit për Bregdetin, për krijimin e një sistemi për menaxhimin e integruar të plazhit dhe bregdetit, ku të përcaktohen kompetencat dhe përgjegjësitë e njësive të pushtetit vendor dhe institucioneve qendrore.

Në figurën më poshtë gjeni të paraqitur numrin e rekomandimeve për përmirësime ligjore, sipas subjekteve/temës përkatëse të auditimit:

Infografik nr. 5: Rekomandimet për përmirësime ligjore




Infografik nr. 5: Rekomandimet për përmirësime ligjore



1.4.2 Gjetje me efekte negative në të ardhura dhe shpenzime

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, janë dhënë 697 rekomandime mbi gjetje me efekte negative në buxhetin e shtetit, për total vlerën 16,472,676 mijë lekë, nga të cilat: dëmi ekonomik vlerësuar 489,628 mijë lekë, menaxhimi jo efektiv i fondeve në vlerën 14,225,499 mijë lekë dhe 1,757,548 mijë lekë në mangësi në aktivitetin kontrollues tatimor/doganor

Infografik nr. 6: Efektet negative financiare në buxhet sipas fushave kryesore (në '000 lekë)




Vlera e efekteve financiare me pasojë dëm ekonomik* në buxhetin e shtetit, është konstatuar 96% në fushën e shpenzimeve dhe 4% në fushën e të ardhurave. Në fushën e shpenzimeve, peshën më të madhe (75%) e zënë shkeljet e konstatuara përgjatë procedurave të prokurimit dhe zbatimit të punimeve/kontratave në vlerën 352, 295 mijë lekë (likuidime për punime të pakryera, mos llogaritjeve të kostove përfundimtare të shërbimit të projektimit, punime jo ne perputhje me specifikimet teknike, etj).

Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë periudhës janar – dhjetor 2024, ka evidentuar shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ* në performancën e administrimit të të ardhurave, shpenzimeve dhe në përdorimin e fondeve publike në vlerën totale 14,225,499 mijë lekë nga të cilat:

- 7,648,646 mijë lekë në fushën e të ardhurave (ose rreth 54% e totalit) kryesisht në të ardhurat e qeverisjes lokale për çështje që lidhen me detyrime për taksat dhe tarifatat vendore, mos tarifimit/përlllogaritjes së gabuar/mos aplikim të kamat vonesave për përdorimin e pronave të bashkisë nga subjektet private; detyrimeve të pashlyera për subjektet që ushtrojnë aktivitete në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë etj; si dhe shkelje në fushën e marrëveshjeve hidrokarbure; mangësi në zbatimin e kontratave koncesionare në fushën e shëndetësisë për pagesa për shërbime të pakryera apo në koncesionin e shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, procesi i dhenies me koncesion, i pa shoqëruar me ndryshimet ligjore përkatëse.

- 6,576,853 mijë lekë në fushën e shpenzimeve (ose rreth 46% e totalit), si rezultat i shkeljeve të disiplinës buxhetore lidhur me likuidimin e shpenzimeve, keq menaxhimin e fondeve të programuara, mungesë kontrolli në realizimin e procedurave të prokurimit jo në përputhje me kuadrin ligjor, etj.



→ 1,757,548 mijë lekë në fushën e të ardhurave

KLSH, për periudhën janar – dhjetor 2024, ka konstatuar mangësi në aktivitetin kontrollues tatimor me ndikim negativ në performancën e administrimit të të ardhurave tatimore & doganore, si detyrime dhe penalitete të vlerësuara në vlerën 1,757,548 mijë lekë, konstatuar si:

- detyrime të vlerësuara në vlerën 569,826 mijë lekë në Degën Doganore Kakavijë, Drejtorinë Rajonale Tatimore, Fie, Drejtorinë Rajonale Tatimore, Vlorë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve; dhe
- penalitete të vlerësuara në vlerën 1,187,722 mijë lekë në Degën Doganore Kakavijë, Tiranë , Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, si dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore Fier dhe Vlorë.

Tabela në vijim paraqet vlerën e dëmit ekonomik, menaxhimit jo efektiv të fondeve, dhe mangësive në aktivitetin kontrollues tatimor me ndikim në performancën e administrimit të të ardhurave tatimore/doganore, të organizuar sipas fushave ku është konstatuar parregullsia:

Tabela nr 3: Efektet financiare negative sipas fushave (në '000 lekë)


Efekte negative financiare	Dem ekonomik	Menaxhim joefektiv	Ndikim negativ tatime/dogana (aktiviteti kontrollues)	Gjithsej
Shpenzime (A)	472,373	6,576,853	-	7,049,226
Koncesione	-	63,976		63,976
Procedura prokurimi	126,744	1,953,143		2,079,887
Shpenzime operative	73,476	2,500,466		2,573,942
Shpenzime per paga, shperblime & sigurime shoqerore	37,715	114,565		152,280
Shpenzime të Tjera	8,887	1,457,490		1,466,377
Zbatim punimesh	225,551	487,213		712,764
Te Ardhura (B)	17,255	7,648,646	1,757,548	9,423,450
Detyrime tatimore të vlerësuara			569,826	569,826
Koncesione		2,497,177		2,497,177
Penalitete të vlerësuara			1,187,722	1,187,722
Te Ardhura ne Urbanistike		204,693		204,693
Te ardhura nga administrimi i pasurisë shtetërore dhe marrëdhëniet kontraktuale me palët e treta	320	316,878		317,198
Te Ardhura të Tjera		188,675		188,675
Të ardhurat nga sektori i tatimeve në qeverisjen lokale	16,935	4,438,376		4,455,311
Zbatim punimesh		2,847		2,847
Gjithsej (A+B)	489,628	14,225,499	1,757,548	16,472,676

1.5 Masa disiplinore dhe administrative

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH, për të metat dhe shkeljet e konstatuara, ka adresuar tek subjektet e audituara 1029 rekomandime për masa administrative dhe disiplinore, nga të cilat 993 masa disiplinore dhe 66 masa administrative.

Konkretisht, për shkeljet e konstatuara në bazë të ligjit të mësipërm, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, neni 58 dhe Kodit të Punës, KLSH u ka kërkuar organeve respektive shqyrtimin dhe marrjen e 861 masave disiplinore (pasi për 132 masa të tjera, punonjësit kanë rezultuar të larguar nga puna).


Infografik nr. 7: Masat disiplinore sipas kuadrit ligjor përkatës




Bazuar në Ligjin Nr.154, atë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH, për të metat dhe shkeljet e konstatuara, ka adresuar tek subjektet e audituara 66 masa administrative.

Konkretisht, për shkeljet e konstatuara, KLSH u ka kërkuar organeve respektive (APP, IMTV, institucionit përgjegjës sipas kuadrit ligjor përkatës) shqyrtimin dhe marrjen e 66 masave administrative, si në infografikun më poshtë:

Infografik nr. 8: Masat administrative sipas llojit




2. MESAZHET NË AUDITIMET E PERFORMANCËS



BARAZIA GJINORE DHE FUQIZIMI I GRAVE NGA ZONAT RURALE, PËRMES PËRFSHIRJES NË TREGUN E PUNËS

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive duhet të intensifikojë bashkëpunimin me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për të identifikuar nevojat e grave rurale, si dhe më pas të hartojë programe të nxitjes së punësimit, në vlerësim të potencialit dhe aftësive të tyre në fusha të ndryshme, si bujqësia, shërbimet sociale, arsimi, teknologjia, etj.

Nxitja e programeve të punësimit në vlerën e diversitetit dhe kontributit të çdo anëtari të komunitetit në ndërtimin e një shoqërie të fortë dhe të qëndrueshme të hartuara dhe të zbatuara nga për vitet 2020-2023, për gratë janë të përgjithshme dhe nuk japin plotësisht, panoramën e gjithë rajoneve dhe referuar vlerësimit të nevojave. Infrastruktura vendore nuk nxit përfshirjen e grave rurale në tregun e punës, pasi në zonat rurale mungojnë çerdhet, ndërsa shërbimi i kopshteve nuk ofrohet në të gjitha njësitë administrative rurale si dhe mungon transporti publik nga njësia qendër drejt të gjitha njësive administrative të bashkive.



EFEKTIVITETI I PAJISJEVE MJEKËSORE NË SISTEMIN SPITALOR PUBLIK

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të nxisin një qasje bashkëkohore dhe ndërgjegjësuere ndaj menaxhimit të pajisjeve mjekësore nëpërmjet harmonizimit të kuadrit ligjor e rregullator me Direktivat e Bashkimit Evropian, dhe përfitimeve që japin praktikën e mira, në mënyrë që të ofrohet siguri në përdorimin e pajisjeve mjekësore në shërbimin shëndetësor publik. Paqartësia në politika, mungesa e përfshirjes në objektivat strategjike, mangësitë në legjislacion, etj., në përdorimin e teknologjisë në diagnostikimin dhe trajtimin mjekësor me synim modernizimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor ka krijuar hapësira për dublim kompetencash dhe parregullsi në menaxhimin dhe administrimin e pajisjeve mjekësore në rang vendi. Mungesa e vlerësimit të investimeve të kryera, analizave kosto përfitim, kostove të mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore e vënien në punë të atyre ekzistuese, nuk mund të garantojnë mirë funksionimin gjatë gjithë ciklit normal të jetës së tyre.



RESPEKTIMI I STANDARDEVE NË TRAJTIMIN DHE ELIMINIMIN E MBETJEVE SPITALORE, NË PARANDALIMIN E RREZIKUT PËR SHËNDETIN E PERSONELIT SHËNDETËSOR, PACIENTËVE DHE MBROJTJEN E MJEDISIT

Mbetjet spitalore dhe trajtimi i tyre për vetë rreziqet që shfaq mbeten një sfidë e vazhdueshme për institucionet shëndetësore si prodhuesit kryesor të tyre. Prodhuesit e mbetjeve spitalore (spitalet rajonale), nuk kanë respektuar masat për administrimin e mbetjeve spitalore të gjeneruara, për sa i përket ndarjes në burim të mbetjeve spitalore, ambalazhimit, etiketimit, magazinimit, trajtimit, transportimit dhe asgjësimit në mënyrën më të mirë të përshtatshme. Spitalet Rajonale duhet të bëjnë hapa përpara në drejtim të plotësimit të standardeve në menaxhimin e sigurt të tyre. Ndërsa, menaxhimi i mbetjeve spitalore përveç se nuk respekton standardet mjedisore, shkakton probleme serioze shëndetësore në komunitet si dhe efekte negative në ekonominë lokale. Në të njëjtën linjë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në rolin e politikbërësit dhe mbikëqyrësit të shërbimit spitalor paraqet nevojën të kryej një vlerësim të qartë dhe objektiv të situatës me të gjithë aktorët e përfshirë, për përmirësim të proceseve ekzistuese dhe marrjen e masave të përshtatshme duke patur në fokus mbrojtjen e shëndetit, ruajtjen e mjedisin si dhe përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike.



RESPEKTIMI I STANDARDEVE NË MENAXHIMIN E MBETJEVE URBANE - SFIDË E QËNDRUESHME NË ZVOGËLIMIN E NDOTJES SË MJEDISIT DHE MBROJTJEN E SHËNDETIT TË POPULLSISË

Menaxhimi i mbetjeve urbane vijon të mbetet një sfidë e vazhdueshme për Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë dhe Korçë. Këto bashki nuk kanë garantuar menaxhim të integruar të mbetjeve urbane duke mos zbatuar hierarkinë e mbetjeve në drejtim të parandalimit, ripërdorimit, reduktimit dhe riciklimit. Gjithashtu, këto bashki nuk kanë arritur të minimizojnë kostot e menaxhimit të mbetjeve për të përfituar të ardhura nëpërmjet metodologjisë së trajtimit të tyre. Në veçanti, në Bashkinë Durrës, menaxhimi i mbetjeve urbane nuk garanton qëndrueshmëri financiare sepse nuk mbulohen shpenzimet me të ardhurat e krijuara. Ndërsa, menaxhimi i mbetjeve urbane në Bashkinë Vlorë përveç se nuk respekton standardet mjedisore, shkakton probleme serioze shëndetësore në komunitet si dhe efekte negative në ekonominë lokale dhe turizmin bregdetar. Është e rëndësishme që këto bashki të angazhohen për të ndryshuar këtë situatë dhe për të krijuar një mjedis sa më të pastër dhe të shëndetshëm për të gjithë.



RPOLITIKAT DHE RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË PERSONAVE ME PROBLEME TË SHËNDETT MENDOR NË SHËRBIMIN SPITALOR PSIKIATRIK

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të krijojë një qasje gjithëpërfshirëse për të garantuar të drejtat dhe trajtim e duhur për personat me probleme të shëndetit mendor, adresuar çështjet, zgjidhjen e problemit të pacientëve rezidentë kronikë, si dhe zgjidhjes problematikave për të dënuarit me masë mjekësore.

Të trajtojë me prioritet sfidat dhe problematikat e shërbimit të shëndetit mendor për unifikimin organizativ të shërbimit; rishikimin e miratimin e rregulloreve; miratimin e protokolleve të unifikuara; garantimin e fondeve buxhetore dhe infrastrukturës së duhur për të trajtuar e akomoduar sipas standardeve pacientët me probleme të shëndetit mendor; funksionimin e Këshillit Kombëtar të Shëndetit Mendor; respektimin e marrëveshjes së bashkëpunimit për ngritjen e institucionit mjekësor të posaçëm nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Drejtësisë për respektimin e standardeve të trajtimit njerëzor të pacientëve të dënuar me masë mjekësore.



PROCESI I BIRËSIMIT TË FËMIJËVE DHE GARANTIMI I TË DREJTAVE TË TYRE PËR MIRËRRITJE DHE EDUKIM

Institucionet përgjegjëse për birësimin në Shqipëri nuk kanë garantuar zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore në fuqi, si parakusht për mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës përgjatë procesit të birësimit vendas dhe ndërvendas, duke cenuar procesin e duke mos reflektuar në shkallën më të lartë parimet themelore të sanksionuara në Konventën për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin në lidhje me Birësimin Ndërvendas.

Komiteti Shqiptar i Birësimeve së bashku me Ministrinë e Drejtësisë, duhet të inkurajojnë një qasje të qëndrueshme në mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës.

Këto institucione duhet të koordinojnë veprimtarinë e tyre dhe të plotësojnë legjislacionin në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Ato duhet të nxisin: bashkëpunimin në fushën e birësimit ndërvendas; vlerësimin dhe sigurimin e kushteve të duhura për mirërritjen e fëmijës; monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të procesit të birësimit si dhe identifikimin e çdo sfide ndaj sigurimit të mirëqenies dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve të braktisur.



MBËSHTETJA FINANCIARE E STUDENTËVE TË SHKËLQYER DHE NËPUNËSVE CIVILË TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE (FONDI I EKSELENCËS)

Krijimi i një qasje të re të bashkëveprimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me strukturat e saj të varësisë, për shkollimin e studentëve ekselentë dhe kërkimin e avancimin e dijes së nëpunësve civilë, si një pasuri të jashtëzakonshme është investimi më i mirë që një shoqëri mund të bëjë për të ardhmen e saj.

Institucionet përgjegjëse nuk kanë garantuar, zbatimin e strategjisë; bazës ligjore dhe nënligjore në fuqi; monitorimin dhe gjurmimin e vazhdueshëm të studentëve apo nëpunësve civilë përfutues të Fondit të Ekselencës për kthimin dhe punësimin e tyre në Shqipëri; respektimin e detyrimeve kontraktuale të nënshkruara nga të dy palët Student-Ministri Arsimit dhe Sporti sipas akt marrëveshjeve për një periudhë 10 vjeçare; duke cenuar procesin dhe mundësitë e financimit më tej të studentëve apo nëpunësve civilë për arsimim dhe përparim të dijeve e ngritjen e talenteve të reja në një fushë të caktuar.



EFEKTIVITETI DHE SIGURIA E BARNAVE QË QARKULLOJNË NË SHQIPËRI

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore të vijojnë punën në garantimin e një sistemi të qëndrueshëm për sigurimin e cilësisë dhe sigurisë së barnave, për të mbrojtur shëndetin e popullsisë dhe përmirësuar besimin publik në sistemin shëndetësor, nëpërmjet përmirësimit të legjislacionit dhe rregulloreve në përputhje me standardet ndërkombëtare për cilësinë dhe sigurinë e barnave; rritjes së kontrollit dhe përforcimit të procedurave të sigurisë; implementimit të teknologjive të avancuara të testimit të cilësisë së barnave; kualifikimit dhe trajnimit të personelit; forcimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve; ndërmarrjes së fushatave të ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe profesionistëve të shëndetësisë mbi rëndësinë e përdorimit të barnave të sigurta dhe të kontrolluara dhe inkurajimit të raportimit nga pacientët dhe mjekët mbi efektet anësore ose defektet e mundshme të barnave.



ZBATIMI I PLANIT KOMBËTAR PËR PËRSHTATJEN NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Gjatë dy dekadave të fundit, sfida e ndryshimeve klimatike është përballur me një qasje për përgjegjësi të përbashkët në nivel ndërkombëtar. Kjo përfshin përpjekje për shtimin e masave të përshtatjes për të luftuar ndikimet e dëmshme të ndryshimeve klimatike që janë ndërkaq të pashmangshme. Nëpërmjet hartimit të Planit Kombëtar të Përshtatjes, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit synon marrjen e masave të suksesshme, me qëllim kundërpërgjigjen ndaj ndryshimeve klimatike. Megjithatë, pavarësisht veprimeve prioritare të përcaktuara, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka luajtur një rol proaktiv në respektim të nismës integruese gjithëpërfshirëse për procesin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, si një qasje relativisht e re, ende nuk mbështetet me kapacitete të përshtatshme në vend. Nuk është krijuar një sistem i mirëfilltë monitorimi dhe vlerësimi dhe pjesa më e madhe e financimit të projekteve lidhur me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri është shumë e varur nga komuniteti ndërkombëtar dhe donatorët. Në vijim, është e rëndësishme që Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa, me qëllim që procesi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike të jetë më efektiv, duke siguruar zbatimin e masave dhe nxjerrjen e mësimeve në mënyrë periodike.



MBROJTJA E VLERAVE DHE PASURIVE TË VENDIT TONË NË UNESCO

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) nuk ka hartuar apo miratuar ende rreth 46% të akteve nënligjore në zbatim të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, i miratuar që në vitin 2018. Projektet infrastrukturore që zhvillohen në sitet e trashëgimisë kulturore të regjistruara në Listën e Trashëgimisë Botërore nuk marrin “Vlerësim të Ndikimit në Trashëgimi (HIA)” para miratimit edhe pse ky është një detyrim i përcaktuar në Udhëzuesin e UNESCO-s. Rekomandimet që lënë misionet e UNESCO-s, nuk merren në shqyrtim nga MEKI, si dhe nuk adresohen për ndjekje dhe zbatim në asnjë institucion publik. Për pasuritë e regjistruara në Listën Tentative duke filluar që nga viti 1996 e në vijim, nuk është marrë asnjë masë, si dhe nuk ka asnjë plan për regjistrimin e tyre në Listën e Trashëgimisë Botërore. Nuk janë hartuar listat e elementëve me të cilët mund të kandidohet në listat përfaqësuese të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të UNESCO-s. Mbrojtja e pasurive kulturore të vendit tonë me rëndësi universale nuk mbështetet sa duhet me fonde buxhetore nga MEKI dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Për të siguruar një mbrojtje të pasurive kombëtare me rëndësi universale, si dhe për të mundësuar regjistrimin e pasurive dhe vlerave të reja në listat e UNESCO-s, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe institucionet përgjegjëse, duhet të zbatojnë detyrimet e Konventave dhe Udhëzuesve, të angazhohen seriozisht në zbatimin e rekomandimeve të misioneve të UNESCO-s, si dhe të rrisin mbështetjen buxhetore dhe bashkëpunimin midis tyre



NDIKIMI I AKTIVITETIT MINERAR NË FONDIN PYJOR

Masat e marra nga institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e fondit pyjor nuk kanë rezultuar të mjaftueshme. Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor dhe Sistemi i Integruar i Informacionit për pyjet nuk funksionojnë duke mos garantuar një informacion të plotë e të përditësuar mbi fondin pyjor. Vetëm 7 nga 87 subjekte që operojnë në sektorin minerar në territorin e bashkive subjekt auditimi janë të pajisura me dokumentin e miratimit të heqjes së fondit pyjor duke sjellë kështu mos përditësimin e regjistrit kadastral të fondit pyjor, me pasojë mungesën e rehabilitimit dhe mos kryerjen e pyllëzimit kompensuesërgjegjëse, duhet të zbatojnë detyrimet e Konventave dhe Udhëzuesve, të angazhohen seriozisht në zbatimin e rekomandimeve të misioneve të UNESCO-s, si dhe të rrisin mbështetjen buxhetore dhe bashkëpunimin midis tyre. Përgjegjës kryesor për këtë situatë është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Bashkitë Krujë, Selenicë, Skrapar, Berat, Dimal, nuk ka pasur inspektime dhe monitorime periodike për aktivitetin minerar që ndikon në fondin pyjor të subjekteve në lidhje me detyrimet për rehabilitimin e mjedisit, ripyllëzimet, parandalimin e dëmtimit të fondit pyjor dhe ruajtjen e tij nga aktiviteti i paligjshëm. Angazhimi i të gjitha institucioneve të sipër përmendura është i rëndësishëm për përmirësimin e situatës në tërësi.



INSPEKTORATET E VENDIT NË MBROJTJE TË INTERESAVE PUBLIKE

Inspektorati Qendror, në cilësinë e institucionit përgjegjës për bashkërendimin e veprimtarisë inspektuese, ka ushtruar kompetencat e veta për të bashkërenduar inspektimet dhe mbikëqyrur ligjin e inspektimeve, si dhe ka miratuar kriteret për arsimimin e inspektorëve dhe rregulla e udhëzime të tjera metodologjike në këtë fushë.

Inspektoratet shtetërore nuk kanë siguruar përputhshmëri midis programeve mujore të inspektimit shkresor me atë elektronik; nuk janë respektuar kriteret e arsimimit të miratuara për punësimin e inspektorëve dhe janë kryer inspektime jashtë portalit “e – inspektimi”, etj. jo në përputhje me orientimet bashkërenduese e metodologjike të miratuara.

Për shkak të problematikave të bazës ligjore, ka pasur mbivendosje kompetencash e inspektimesh nga më shumë se një inspektorat, në veçanti në fushën e mjedisit midis AKM dhe IKMT – së.

Për të garantuar mbrojtje të interesit publik dhe interesave të tjerë të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë është miratuar ligji nr. 99, datë 12.09.2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” i cili synon të unifikojë dhe bashkërendojë veprimtarinë inspektuese në vendin tonë.

Inspektorati Qendror, si promotor në kuadër të ndryshimit të ligjit për inspektimin duhet t’i japë një impuls e kuptim të ri procesit inspektues si domosdoshmëri e rishikimit të problematikave dhe miratimit të rregullave të reja, duke synuar koordinimin dhe harmonizimin e tij në nivel qendror e vendor.



MENAXHIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE NË PLAZHE

Mungesa e një strategjie kombëtare për menaxhimin e integruar të bregdetit, mungesa e kuadrit ligjor për t’i dhënë status juridik të veçantë zonës bregdetare (edhe pse problematikë e evidentuar prej vitesh), cenon efektivitetin e mekanizmit të ngritur për menaxhimin e hapësirave publike në plazhe. Mbivendosja e funksioneve të disa institucioneve që kanë role të ngjashme ose mbivendosja e veprimtarisë së tyre në disa aspekte si mbikëqyrja e cilësisë së shërbimeve, inspektimi për higjienën, etj, mund të shkaktojë dublim të procedurave ose procese të panevojshme me pasoja në cilësinë e shërbimit.

Raporti 30% i plazheve publikë ndaj sipërfaqes së plazheve, nuk është trajtuar me përparësi dhe është i pavërtetueshëm në terren, pasi aplikohet mbi gjithë sipërfaqen territoriale të plazheve dhe jo e ndarë për çdo zonë. Plazhet e dedikuara për publikun nuk plotësojnë standardet e përcaktuara në VKM-së 171/2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar, lidhur me sigurinë dhe cilësinë e tyre. Iniciativat për ndryshime në kuadrin ligjor dhe rregullator të hapësirave publike në plazhe nuk bazohen në analiza kosto përfitim dhe studime, për pasojë rezultojnë struktura të munguara në bashkitë bregdetare, tarifa për zënieën e hapësirës publike të parashikuara prej vitesh, mungesë fondesh të dedikuara për menaxhimin e plazheve, mungesë koordinimi mes institucioneve, struktura të cunguara dhe jo të përshtatshme për monitorimin dhe inspektimin e tyre. Vlerësimi i situatës aktuale të plazheve dhe mekanizmit të ngritur për menaxhimin e tyre nga ana e institucioneve përgjegjëse, do të siguronte një qasje publike të drejtë dhe të qëndrueshme në plazhe dhe një mundësi të mirë për të përmbushur potencialin e plotë turistik të këtyre zonave në funksion të taksapaguesve dhe qytetarëve shqiptarë.



ORIENTIMI PËR KARRIERË I NXËNËSVE, NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Mungesa e një vizioni të qartë politik, mungesa e strukturave dhe fondeve buxhetore, mungesa e marrëveshjeve me grupet e interesit, si dhe mos analizimi i ecurisë së procesit të orientimit të karrierës, kanë sjellë planifikime formale të veprimtarive për këtë qëllim, duke penguar krijimin e një mekanizmi të qëndrueshëm midis institucioneve të arsimit parauniversitar, tregut të punës, si dhe gjithë aktorëve të tjerë të përfshirë në proces. Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e varësisë, duhet të nxisin një qasje bashkëkohore dhe ndërgjegjësuese, ndaj procesit të orientimit të karrierës së nxënësve në sistemin e arsimit parauniversitar, nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor dhe rregullator, si dhe praktikave më të mira.



PROJEKTET KËRKIMORE-SHKENCORE TË REALIZUARA NGA AKADEMIJA E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË, NË NXITJEN E PËRPARIMIT SHKENCOR, TEKNOLOGJIK DHE INOVACIONIT, PËR TË MIRËN E VENDIT

Akademia e Shkencave të Shqipërisë nuk ka siguruar një menaxhim të përshtatshëm të veprimtarisë lidhur me projektet e kërkimit shkencor. Akademia e Shkencave të Shqipërisë nuk ka hartuar një plan strategjik zhvillimor institucional, i cili do të duhej të shpaloste qartë misionin dhe vizionin e tij, të mundësonte përparësitë strategjike, menaxhimin e burimeve, vlerësimin e performancës si dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënies. Akademia e Shkencave të Shqipërisë nuk ka siguruar një menaxhim të duhur të dokumentimit të veprimtarisë lidhur me projektet e kërkimit shkencor duke qenë se mungon një rregullore e qartë për mënyrën e organizimit, orientimit dhe përcaktimit të kriterëve që duhet të përmbushin projektet e propozuara. Gjithashtu rezulton se nuk janë përmirësuar metodikat dhe udhëzuesit mbi programimin, shpalljen e thirrjes për projekte, realizimin, financimin, kontrollin e brendshëm dhe transparencën mbi monitorimin e projekteve kërkimore – shkencore.

3. KONKLuzionet në Auditimet IT



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në, ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, vlerësojmë se teknologjia e informacionit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është konsideruar si një hap kritik drejt sigurisë dhe

besueshmërisë së procesit zgjedhor, por nevojiten të merren masa për të qenë në përputhje me standardet e sigurisë së informacionit. Për përmirësimet e mëtejshme të sistemeve të IT-së në KQZ, nevojitet të merren masa për përmirësimin e kushteve të dhomës së serverave, për të ndërtuar një infrastrukturë qendrore të teknologjisë së informacionit në përputhje me udhëzimet, standardet dhe praktikatat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare. Marrja e masave për hartimin dhe miratimin e Politikave / Procedurave të Sigurisë së Informacionit, me qëllim njohjen dhe minimizimin e riskut të incidenteve që mund të sjellin humbje, tjetërsim apo transferim të informacionit kofidencial që akseson dhe administron institucioni në përputhje me aktivitetin e tij. Gjithashtu marrjen e masave për ndërtimin dhe administrimin e një infrastrukturë të qendëruar të aksesimit në rrjet nga përdoruesit nëpërmjet implementimit të Active Directory, si një nga praktikatat më të mira e parashikuar gjithashtu në standardet ndërkombëtare të sigurisë dhe që ndikon në sigurinë e të dhënave qendrore dhe lokale të përdoruesve.

MINISTRIA E SHENDETESISE DHE MBROJTJES SOCIALE / NE FOKUS SKEMA E NDIHMES SOCIALE

Grupi i auditimit është mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH” datë 27.11.2014. Kemi audituar Sistemet e Teknologjisë së Informacionit për periudhën ushtrimore 01.01.2022-31.12.2023 në të cilat përfshihet Qeverisja IT, Siguria e Informacionit, Investimet në fushën TIK dhe sistemet e teknologjisë së informacionit që Shërbimi Social Shtetëror ka në përdorim dhe mbështet aktivitetin e saj. Kemi konstatuar se, mungesa e akteve rregullatorë në drejtim të sistemeve të teknologjisë së informacionit kanë ndikuar në një zhvillim të pa monitoruar të aktivitetit institucional dhe pa deleguar përgjegjësitë individuale për veprimet e kryera.

Nga analizimi i të dhënave, rezultoi se sistemi i Ndhmës Ekonomike ka mungesë në mekanizmat e nevojshme për kontrollin e inputit, duke rritur riskun e popullimit të sistemit me të dhëna të gabuara, e për pasojë nxjerrjen e rezultateve të pasakta. Implementimi i protokolleve themelore të sigurisë është i pamjaftueshëm. Ka mungesë trajnimi të punonjësve në praktikat më të mira të sigurisë kibernetike. Kjo pakujdesi paraqet një rrezik për konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e informacionit dhe sistemeve. Siguria e Informacionit dhe perspektiva e SHSSH është e kompromentuar nga investimet e pakta në teknologjinë e Informacionit. Në gjykimin tonë, identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në ofrimin e shërbimeve kundrejt qytetareve dhe garantimin e sigurisë së të dhënave si dhe vazhdimësisë në ofrimin e shërbimit pa ndërprerje nëpërmjet teknologjisë së informacionit është i pamjaftueshëm. SHSSH nuk ka marrë masa për kalimin e strukturave përgjegjëse TIK tek AKSHI sipas përcaktimeve dhe afateve të vendosur në VKM Nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË/ KUNDËRVAJTJET RRUGORE

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në, ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, vlerësojmë se sistemi informatik i ndërtuar me qëllim verbalizimin dhe administrimin e të dhënave mbi Kundërvajtjet Rrugore, ka mangësi që ndikojnë në mbarëvajtjen dhe funksionimin e tij. Me ndërtimin e këtij sistemi, nuk është arritur të shmanget plotësisht letra nga veprimtaria operacionale e Drejtorisë së Policisë Rrugore. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, si dy institucionet kryesore që kanë rol të rëndësishëm në arritjen e qëllimit të këtij informatizimi, nevojitet të analizojnë dhe të veprojnë mbi shkaqet që kanë penguar maksimizimin e proceseve të informatizuara në eGjoba. Dy institucionet nevojitet të dakortësojnë gjithashtu mbi rolet e tyre në këtë informatizim, në mënyrë që të sigurohet angazhimi në përmirësimin dhe monitorimin e zhvillimit të këtij sistemi.



AGJENCIA KOMBËTARE E BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në, ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, rezultoi se për Sistemin i Informacionit të Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore paraqiten disa mangësi që kërkojnë vëmendje të menjëhershme nga:

- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, si institucioni përgjegjës për administrimin, krijimin, kontraktimin e shërbimeve, si dhe përmirësimin e infrastrukturës TIK;
- Autoriteti Kombëtar i Sigurisë Kibernetike, si institucioni përgjegjës për Sigurinë Kibernetike;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, si institucioni monitorues i AKBPM-ës.

Mungesa e krijimit të bazës së të dhënave shtetërore, së bashku me heqjen e statusit “Infrastrukturë Kritike e Informacionit”, përbëjnë risk të lartë në mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë e informacionit, për arsye se ky sistem është jashtë vëmendjes dhe i pamonitoruar ndaj sulmeve dhe keqpërdorimeve.

Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore nuk mund të bëjë asnjë përmirësim të situatës e vetme dhe në kushtet në të cilat ndodhet, ku mungojnë:

- Udhëzime specifike për sigurinë e informacionit;
- Strukturat e dedikuara nga AKSHI për IT;
- Një pozicion i dedikuar në strukturë për administrimin e të dhënave, megjithëse përgjegjëse për këto të dhëna;

Kjo mungesë vëmendje, kontrolli dhe mbikëqyrjeje cenon 3 parimet themelore të sigurisë së të dhënave: konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë; duke e vendosur institucionin në mundësinë e krijimit të problemeve serioze në rastet e ndonjë incidenti të sigurisë ose keqpërdorimi të sistemit.

UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A

Grupi i auditimit është mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH” datë 27.11.2014. Kemi audituar Sistemet e Teknologjisë së Informacionit për periudhën ushtrimore 01.01.2022-31.12.2023 në të cilat përfshihet Qeverisja IT, Siguria e Informacionit, Investimet në fushën TIK dhe sistemet e teknologjisë së informacionit që Ujësjiellës Kanalizime Shkodër ka në përdorim dhe mbështet aktivitetin e saj. UKSH Sh.A nuk ka një strategji dhe një plan menaxhimi të rrishtit. Pa një drejtim të qartë strategjik dhe një qasje proaktive për identifikimin e rreziqeve, UKSH Sh.A është e papërgatitur për të përmirësuar infrastrukturën e saj teknologjike. Mungesa e akteve rregullatore në drejtim të sistemeve të teknologjisë së informacionit kanë ndikuar në një zhvillim të pa monitoruar të aktivitetit institucional dhe pa deleguar përgjegjësitë individuale për veprimet e kryera UKSH Sh.A nuk ndjek një politikë të përcaktuar për analizimin e gjurmëve të auditimit për veprimet që kryejnë përdoruesit në sisteme. UKSH Sh.A nuk disponon një politikë/rregullore të dokumentuar dhe miratuar për procesin e menaxhimit të përdoruesve (krijimi, fshirja, ndryshimi i roleve/të drejtave, ndryshimi i fjalëkalimeve). Mungesa e mekanizmave të vazhdueshëm të monitorimit do të thotë që çdo anomali ose aktivitet i dyshimtë brenda sistemit mund të mbetet i pashqyrtuar, duke rritur gjasat e ekspozimit ndaj kërcënimeve. Investimet në fushën e Teknologjisë së Informacionit janë të pamjaftueshme. Kjo mungesë financiare kufizon aftësinë e UKSH Sh.A për të investuar në teknologjitë e nevojshme, për përmirësimin e infrastrukturës, rritjen e sigurisë, vazhdimësinë e punës.

AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në, ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, vlerësojmë se sistemi informatik për administrimin dhe monitorimin e aktivitetit të koncesioneve dhe lejeve minerare mbi burimet natyrore të Republikës së Shqipërisë (Revzone), si dhe sistemi i menaxhimit të licencave dhe koncesioneve (GIS) kanë mangësi që ndikojnë në mbarëvajtjen, përdorimin dhe vazhdimësinë e funksionimit të tyre. Me gjithë përpjekjet dhe investimet në fushën e teknologjisë, situata në AKBN në këtë drejtim nuk është e konsoliduar në krahasim me investimet e kryera, nisur nga fakti se zhvillimi i sistemeve ndër vite nuk është zhvilluar sipas një planifikimi strategjik afatgjatë.

Mungesa e rregulloreve për përdorimin e sistemeve që AKBN disponon ka krijuar mundësinë për mos përdorimin e sistemeve, e si rezultat dhe mos adresimin e përgjegjësive për mungesën e efektivitetit të çdo hapi të informatizuar.

Nga analizimi i të dhënave në sistemin për lejet minerare, rezultoi se sistemi Revzone nuk ka mekanizmat e nevojshme për kontrollin e inputit, duke rritur riskun e popullimit në sistem me të dhëna të cilat tejkalojnë përmbushjen e afateve sipas deklarimeve që duhet të bëjnë subjektet si dhe dublikimin e informacioneve, e për pasojë nxjerrjen e raporteve të pasakta.

Sistemet e informacionit nuk kanë arritur qëllimet e investimeve të kryera në lidhje me informatizimin e proceseve, zhvillimin e shërbimeve si dhe sigurimin e vazhdueshmërisë në ofrimin e shërbimeve.



AGJENCIA PËR ZHVILLIMIN BUJQËSOR DHE RURAL

